

Dalës-Izlazje

Nr. -1-27  
Br.

Data 22.02.2021  
Datum

OBILIQ-OBILIC



**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic**

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

**Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI<sup>46</sup>, mbledhja e 2 ) me dt.26.02.2021  
( e premte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti vjetor i Kuvendit komunal
4. Plani i punës së Kuvendit komunal për vitin 2021
5. Bartja e mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021
6. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-90, të dt.19.02.2021
7. Shqyrtimi i kërkesave të DKRS-së
  - a) Qendra rinore
  - b) Këshilli i veprimit rinor lokal
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.01.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

**Të pranishmit tjere:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtori i komunal, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, përf. i Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq dhe përf. i IZHL-së Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstataoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
3. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës
5. Shqyrtimi i Propozimvendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë (Zona industriale - Llazarevë)
  - a) Nic Home SH.P.K
  - b) Tehno Burimi d.d
  - c) NTP "trod ex"
  - d) One Group SH.A
  - e) Aztech SH.P.K
  - f) B.P Home Invest
  - g) N.T.P "EBF"
  - h) N.M.A sh.p.k
  - i) Termo Pan
  - j) CNC.SHPK
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

**Aziz Bici** – Në leximin e ekstraktit të procesverbalit shohë se të dhënat e asambleistëve, sa i përket përkatësisë partiake nuk janë të sakta duke marrë parasysh kalimin e 3 anëtarëve të LDK-së, në AAK, fjala është për Shaip Palojen, ish shefin e grupit të LDK-së, që përkundër kalimit në AAK, ai vazhdon të mbajë postin e njejtë si më heret si dhe Fatmir Bekteshin dhe Arbnore Nasufin. Unë kërkoj që kjo të përmirësohet për shkak se procesverbalet sepse janë dëshmia e asaj çka jemi dhe bëjmë për qytetarët, prandaj ato duhet të janë reale.

**Shaip Paloja** – Është e vërtetë se unë Shaip Paloja, Fatmir Bekteshi dhe Arbnora Nasufi, kemi kalue në AAK, por ne mandatet i kemi nga LDK-ja dhe deri nëfund të mandatit, këto mandate janë të LDK-së dhe të askujt tjetër.. Nëse, eventualisht nesër unë japë dorëheqje këtu, jam kandidati i LDK-së, e jo i AAK-së dhe kjo është e vërteta.

**Kryesuesi** - Nga sekretaria më njoftuan se në të kaluarën kur ka ndodh kalimi i anëtarëve të Kuvendit nga një parti në tjetrën, mandati i ka mbetë partisë.

**Lulzim Sadiku** – Unë kërkoj për shkak të ngarkesave dhe agjendës që kemi të jemi sa më të thukët, të shkojmë sipas rendit të ditës dhe njëkohësisht të ndalemi te pikat e procesverbalit për anëtarët se të cilit subjekt politik janë. Pra, realisht fillimisht duhet të shkojmë me rendin e ditës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan rendin e ditës të cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** - Ju njoftoj se Nora Preniqi, nga radhët e LB-së, mungon dhe ajo më ka njoftuar se do ti nënshtronhet një operacioni kirugjik dhe ne i dëshirojmë shërim sa më të shpejtë.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura më lartë, gjithsesi edhe me konsultimin nga zyra ligjore sa i përket mandateve të anëtarëve të Kuvendit komunal, të cilit i kanë takuar.

**Lulzim Sadiku** – Nëse, merret konsultimi nga zyra ligjore, neve na ndryshon renditja pasi që jemi grupi i dytë më i madh.

#### **Pika e 3's e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga DKRS-ja, për Draft Statutin e Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq.

**Ilire Kelmendi Shema** – Unë kam kënaqësinë që bashkë me Kryetarin e Komunës, kemi arritë bashkarisht që të marrim përsipër një punë të rëndësishme për Ansamblin e qytetit, në fillim të bëjmë themelimin e saj, pastaj Statutin i cili është i pari në nivel të Komunave. Po ashtu i falenderoj përzemërsisht edhe anëtarët e Kuvendit komunal, të cilët na kanë përkrahë deri në fund dhe shpresoj se edhe në të ardhmen do të na përkrahi.

Pastaj, drejtoresha shpjegoi çështjen e llogos të këtij dokumenti, të cilën e kanë bërë z.Besnik Grajqevci bashkë me Komisionin.

**Lulzim Sadiku** – Unë i përgëzoj për punën e bërë rrëth llogos. Kjo llogoja e Komunës këtu, poshtë po duketdiçka jo e domosdoshme dhe ka qenë mirë të gjendet një formë sepse në shikim të parë po duket në mesin e tyre në anën e pasme, që përfundon jo mirë. Mendoj se mund të jetë psh shkronja 'O psh Obiliqi, të ketë llogon tonë' dhe të shenohet me 'O' sepse në shikim llogoja po delë shumë poshtë dhe shumë e vogël.. Vërtetë, është një punë e madhe që është bërë dhe po bëhet, që është për me përgëzue, por propozoj që llogoja të analizohet edhe njëherë. Ne jemi pro që nga themelimi dhe do të jemi pro gjithmonë bashkë me juvë, që të ju ndihmojmë në çdo formë që kërkohet prej Kuvendit komunal.

**Aziz Biki** – Unë do të flas rrëth llogos. Në llogen e Ansamblit figuron mbishkrimi i plotë i emrit zyrtar edhe në gjuhën sërbe; megjithatë aktin e padrejtë që thekson përdorimin e 'O' gjuhëve zyrtare në secilin institucion në dokument, do të bëhet në secilin sektor e domosdoshme, që të figuron edhe në llogen e Ansamblit. Të parëm 'gjuhë' që do të ketë atë simbol, është meritë e listës sërbe, si instrument nga Beograd, që përmes veprimeve të vazhdueshme vazhdon të tregoj armiqësinë edhe për kulturën shqiptare. Prandaj, ne si LVV në këtë rrethana do të votojmë kundër. Shpresoj se në të ardhmen komuniteti serb në Kosovë, të krijon një iniciativë qytetare që bazohet në zhvillimin dhe fuqizimin e shtetit të Kosovës, largë instrumentalizimit të ndikimit nga Beograd. Kjo, nuk është pyetje për juve që e keni hartuar Draftin, por kjo është kërkesë për asambleistët, Kryetarin dhe kryesuesin.

**Kryesuesi** – Institucionet e Republikës së Kosovës, punojnë në bazë të LVL-së dhe ligjeve tjera sektoriale. Këtu, ne të gjithë jemi të barabartë para ligjit, me të gjitha komunitetet sepse ligji e ka përcaktue këtë çështje.

**Fatos Kurshumlija** – Edhe ne si grup i LDK-së, e përkrahim themelimin e Ansamblit të qytetit.

**Kryetari** – Unë e falenderoj shumë DKRS-në, drejtoreshën Ilire, me të gjithë të tjerët që janë prezentë këtu, për angazhimin e madh deri në sjelljen e Draftit në Kuvend. Shpresoj se kjo do ti ndihmon shumë zhvilimeve të reja në Komunën tonë, sidomos të rinjëve që merren me kulturë.

**Hysni Mjeku** – Unë në parim e përkrahu llogen me disa vërejtje. Propozoj që te llogoja e Komunës, të jetë ligji i themelimit 2020, ndërsa më lartë të vendoset llogoja e Komunës me shkronjën O sepse nëse nuk figuron viti i themelimit të Ansamblit, atëherë ne nuk kemi bërë asgjë. Ndërsa, për të tjerat u tha nga drejtoresha dhe unë jashtëzakonisht e përkrahu dhe uroj që të jetë e kapshme për të gjithë qytetarët.

**Kryesuesi** – Llogoja është e rregulluar me Udhëzim administrativdhe ne nuk mund të dalim jashtë Udhëzimit administrativ. Draft Statuti i Ansamblit të këngëve dhe valleve gjithsejt i ka 23 nene dhe neni 7 është për kulturën dhe historinë e qytetit të Obiliqit, do të jetë trashëgimi e qytetit të Obiliqit. Vlen të theksohet se është hera e parë që ne duke e ruajtar trashëgiminë e kulturës së Obiliqit, që nga themelimi nga viti 63, 46, ky Ansambël e ka përgjegjësinë më të madhe në aspektin kulturor për të gjitha etnititetet në Komunën e Obiliqit. Z. Hysni Mjeku, viti nuk shenohet sepse është e rregulluar me Udhëzim administrativ, ndërsa është obligative që llogoja e Komunës të jetë në 3 gjuhët.

**Lulzim Sadiku** – Po më befason që po thua se llogoja e Komunës e ka vitin 1946, ne jemi pro këtij. Draft Statuti, por kërkoi sqarim për këtë çështje.

**Kryesuesi** – Sqaron se ne e kemi themeluar edhe Bibliotekën e qytetit dhe shumë shpejtë do ta kemi edhe Draft Statutin e Bibliotekës së qytetit dhe mendoj se kjo është çështje teknike. Propozimi i Komisionit të Kuvendit komunal dhe grupit që është marrë në mënyrë permanente mbi 6 muaj, këtë formë e kanë propozuar.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për dhe 1 votë kundër e aprovuan Statutin e Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq.**

#### **Pika e 4-e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Draft Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se 1 vit të të pronës së paluajtshme të Komunës, ka dalë në debat publik dhe juve, iu ka ardhë për shqyrtim dhe aprovim.

**Shaip Paloja** – Mua, më intereson se për marrjen e pronave komunale në shfrytëzim më pak se 1 vit, a do të kenë përparësi qytetarët e Obiliqit. Unë nuk kam mund me lexue që parashihet një përparësi vetëm për qytetarët e Obiliqit. Unë nuk e di se a e regullon ligji këtë çështje, por rreth kësaj e kërkoi një sqarim.

**Kryesuesi** – Sqaron se Rregullorja në mënyrë taksatieve flet për nivelin komunal dhe shumica e rasteve janë qytetarë të Komunës së Obiliqit. Ne nuk mund të themi vetëm për qytetarët e Obiliqit, sepse është diskriminim ligjor ndaj të tjerëve, të cilët kanë biznese qe 20 vite në Obiliq.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.**

#### **Pika e 5-e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju materialin e keni marrë dhe keni qenë prezentë me diskutue se çka do të investohet nga investitorët potencial në zonën industriale – Llazarevë.

Tani, kryesuesi paraqiti Propozimvendimin nr.1, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë a) Nic Home SH.P.K.

**Enver Gashi** – Ne jemi për dhënien e kësaj prone komunale.

**Hysni Mjeku** – Ne jemi të hapur për biznese, nëse i plotësojnë kriteret dhe unë kërkoj falje që nuk kam mund të marrë pjesë në atë takim. Mendoj se nëse, jemi për mbështetje të bizneseve, ne duhet të bëjmë dikça.

**Fatos Kurshumlija** – Edhe ne jemi për dhënien e kësaj prone komunale.

**Aziz Bici** – Sa i përket shqyrtimit dhe miratimit të dhënies së pronave komunale për 99 vite, siç e dini pa një instrument inspektimi që përcjellë punën e këtyre kompanive, ne jemi kundër një sakifice të tillë të punës, të dhënies në shfrytëzim për 99 vite, të tokës bujqësore. Këtë e kemi thënë në diskutim në çdo seancë me ardhjen e LVV-së, në pushtet për të gjitha këto veprime do të jepet përgjegjësi sipas ligjit. Prandaj, ju ftoj të mos i votoni propozimet e z.Xhafer Gashi, Kryetar.

**Kryetari** – Mendoj se e drejta ligjore është sipas ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe mund ta korrigjoj parafolësin se nuk janë toka bujqësore, por me planin zhvillimor është zonë industriale. Unë jam i nderuar që ne si Komunë, që flasim çdo ditë për zhvillim ekonomik, ti kemi mundësitë me iu ofruë bizneseve sipas një statistike të përafertë të gjithë atyre, që kanë bërë prezentime deri më tanë dhe në këtë zonë pritet mbi 1,000 njerëz të angazhohen. E drejta ligjore neve na mundëson që ne si Ekzekutiv, ti sjellim vetëm propozimet në bashkëpunim me të gjithë të interesuarit me anëtarë të Kuvendit. I nderuari kryesues, kemi bërë një prezentim paraprak ku secila kompani ka pasë mundësi të ofroj prezentimin e tyre lidhur me investimin dhe interesit tonë që është në veçanti që ato të jenë sipas standardeve evropiane dhe prioritet të kenë qytetarët e Obiliqit për punësim.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe 3 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ NIC HOME SH.P.K ” me adresë : Miloshevë-Obiliq.**

**Kryesuesi** - Paraqiti Propozimvendimin nr.2, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, b) Tehno Burimi d.d.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Fatos Kurshumlija** – Ne do të abstenojmë.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Aziz Bici** – Ne jemi kunër.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 3 vota kundër dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ TEHNO BURIMI D.D SH.A ” me adresë : Shipkovec-Mitrovicë.**

**Kryesuesi** - Paraqiti Propozimvendimin nr.3, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, c) NTP ”trod ex”.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Xhezide Dragusha** – Ne jemi kundër

**Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 1 votë kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ N.P TRO -DEX ” me adresë : Fushë Kosovë, Dardani 24.**

**Kryesuesi** - Paraqiti Propozimvendimin nr.4, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, d) One Group SH.A.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Fatos Kurshumlija** – Ne jemi për këtë vendim.

**Xhezide Dragusha** – Ne jemi kundër.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 1 votë kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ ONE GROUP SH.A ” me adresë :Fushë Kosovë , Rr: 17 Shkurti, objekti 21, lokal nr 5.**

**Kryesuesi** - Paraqiti Propozimvendimin nr.5, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, e) Aztech SH.P.K

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Fatos Kurshumlija** – Ne jemi për këtë vendim.

**Aziz Bici** – Ne jemi kundër.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “AZTECH SH.P.K ” me adresë: Graçanicë – Llapnasell km3 Graçanicë.

Kryesuesi - Paraqiti Propozimvendimin nr.6, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, f) B.P. Home Invest.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Fatos Kurshumlija** – Ne jemi për këtë vendim.

**Aziz Bici** – Ne jemi kundër.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ BP HOME INVEST SH.P.K ” me adresë :Prishtinë , Josip Rela H5 NR.3.

Kryesuesi - Paraqiti Propozimvendimin nr.7, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, g) N.T.P "EBF".

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Fatos Kurshumlija** – Ne jemi për këtë vendim.

**Aziz Bici** – Ne jemi kundër.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ N.T.P EBF ” me adresë :Prishtinë , Lidhja e Pejës ,Nr 300/1.

Kryesuesi - Unë kërkoj falje sepse nuk e kam propozimvendimin e radhës, por kalojmë te propozimvendimi tjetër, pastaj prapë kthehem i te propozimvendimi i caktuar.

Tani, kryesuesi paraqiti Propozimvendimin nr.9, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, i) Termo Pan.

**Enver Gashi** – Ne jemi për këtë vendim.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Aziz Bici** – Ne jemi kundër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit “ N.P.SH TERMOPAN ” me adresë : Prishtinë ,Velani, Isa Kastarti.

Kryesuesi - Paraqiti Propozimvendimin nr.10, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, j) CNC.SHPK.

**Enver Gashi** – Ne jemi kundër këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Ne jemi kundër këtë vendim.

**Aziz Bici** – Ne jemi kundër.

**Nazmi Gashi** – Edhe ne jemi kundër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota kundër dhe 1 votë për nuk e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës investitorit “CNC.SHPK”.

Kryesuesi - Paraqiti Propozimvendimin nr.8, të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë - Zona kadastrale Llazarevë, h ) NMA.SHPK.

**Enver Gashi** – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Hysni Mjeku** – Edhe ne jemi për këtë vendim.

**Arbnore Nasufi** – Pyeti se me çka merret kompania në fjalë .

Kryesuesi - Përgjegjet me dyer e dritare.

**Kryesuesi - Pergjegjet me dyer e ditare:**  
**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për dhe me 1 votë kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ofertuesit " NMA SH.P.K " me adresë : Prishtinë.**

### Pika e 6 e rendit të ditës

**Kryesuesi** - Ju njoftoj se në KPF, e kemi pasë vetëm një kërkesë nga Sabit Grajqevci, për ndihmë financiare për bashkëshorten e sëmurë dhe këtë kërkesë ia kemi dërguar DSHMS-së, për shqyrtim.

### Pika e 7 e rendit të ditës

**Aziz Bici** – Deshta ta ndaj me ju, që nuk e dini një tragedi që ka ndodhë në Komunën tonë në fshatin Mazgit i Epërm, ku nëna duke u përpjekur që ta dërgonte djalin e vet te mjeku në pamundësi që të kaloj nënkalimin që ishte mbushur plot me ujë, në magjistralen Prishtinë-Vushtrri, e ka humbur jetën në sy të djalit 5 vjeç. Ne si LVV, e kemi ngritur këtë çështje problematike edhe më heret në nënkalimin në fshatin Milloshevë, ku jeni shprehur se kjo është kompetencë që i takon nivelit qëndror. Duke qenë i vetëdijshëm se kompetencat për këtë i takojnë nivelit qëndror, unë insistoj të përmendë performancën e dobët të inspektorëve në këtë rast dhe shumë raste tjera, që duhet ta kryejnë detyrën e vet. Pra, të hetojnë dhe veprojnë në mënyrë që të zbatohet e drejta themelore e qytetarëve tonë, e drejta për siguri. Prandaj, organet e përgjegjësisë duhet të kërkojnë përgjegjësi dhe llogari për këtë ngjarje tragjike nga institucionet e personat përgjegjës, për shkak se nuk është ngjarje e cila thjeshtë duhet lënë.

Deshtra ta ndaj me ju, që nuk e dini një tragjedi që ka ndodhë në Komunën tonë në fshatin Mazgit i Epërm, ku nëna duke u përpjekur që ta dërgonte djalin e vet te mjeku në pamundësi që të kaloj nënnkalimin që ishte mbushur plot me ujë, në magjistralen Prishtinë-Vushtrri, e ka humbur jetën në sy të djalit 5 vjeç. Ne si LVV, e kemi ngritur këtë çështje problematike edhe më heret në nënkalimin në fshatin Milloshevë, ku jemi shprehur se kjo është kompetencë që i takon nivelit qëndror. Duke qenë i vetëdijshëm se kompetencat përkohëse se kjo është kompetencë që i takon nivelit qëndror, unë insistoj të përmendë performancën e dobët të inspektorëve në këtë rast dhe shumë raste tjera, që duhet ta kryejnë detyrën e vet. Pra, të hetojnë dhe veprojnë në mënyrë që të zbatohet e drejta themelore e qytetarëve tonë, e drejta për siguri. Prandaj, organet e përgjegjësisë duhet të kërkojnë përgjegjësi dhe llogari përkëtë ngjarje tragjike nga institucionet e personat përgjegjës, për shkak se nuk është ngjarje e cila thjeshtë duhet lënë.

**Dragan Dancetovic** – Ne jemi dëshmitarë se këtyre ditëve ka rënë shumë borë dhe shi dhe në territorin e Komunës tonë ka pasur vërvshime. Komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes, por ky është një rast i mirë që të tregojnë se si duhet të zgjidhet problemi në mënyrë sistematike. Po ashtu, ka pasë shumë dëmtime në shtëpi, oborre dhe toka bujqësore, por dëmet do të ishin shumë më të mëdha sikur mos të pastroheshin shtrati i lumenjve dhe kjo ka dhënë rezultate pozitive. Unë po e paraqes rastin, që është shprehur më shumë në fshatin Baimoc, ku kemi pasë shumë problem me ujin e kanalit Ibër-Lepenc. Po ashtu, kemi pasë problem edhe me kanalizim sepse gypat nuk kanë pranuar me kapacitet të nevojshëm ujin dhe kështu, me ditë të tëra uji ka ecë mbi sipërfaqe të rrugëve. Shpresoj se problemin me kanalizim, sidomos në pjesën e poshtme të magjistralej do ta konkretizojmë dhe ta zgjidhim. Problemi tjetër që dua ta theksoj është se ditëve të fundit sërisht ka pasur vjedhje në fshatin Baimoc. Vitin e kaluar është thënë se do të vendosen kamerat dhe dëshiroj të dijë, të marrë përgjegje se deri ku ka ecë puna në vendosjen e kamerave, që të zgjidhet ky problem. Unë kërkoj përgjegje nësë, ka mundësi.

**Hysni Mjeku** – Unë edhe në KPF, e kam ngritë çështjen e këtyre ditëve që ka pasë vërvshime jashtëzakonisht të mëdha, meqenëse vijë nga zona e fshatit Grabofc i Epërm. E falenderoj edhe Kryetarin që në kohën e duhur ka dalë në vendin e ngjarjes, por meqenëse dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha, është shkatërruar një urë që është ndërtuar nga KFOR-i dhe 2 ura që janë të rindërtuara nga qytetarët, edhe ato janë të rrënuara. Faktikisht, 2 lagje i kemi jashtë qasjes nga rruga publike dhe ata tash shfrytëzojnë vetëm këlimin në rrugën e vjetër që e ka këpupë lumi, ndërsa kalimi me makina nuk është në pyetje sepse rreziku

është i madh. Kërkoj nga Kryetari dhe nga ju ansambleistë, që në kohën e pranverës urgjentsisht të ndërmerr masa që në këto 2 lagje, të ndërtohen urat mbi lumin Drenica. Edhe njëherë e falenderoj Kryetarin dhe Drejtoren përkatëse, por mbi të gjitha është dashur sepse kam kerkuar në KPF, që së paku ta kemi një raport për gjendjen aktuale, jo vetëm të zonës prej nga vijë unë, por nga të gjitha zonat e Komunës tonë. Shpresoj dhe kërkoj, njëkohësisht uroj që mos të ketë më këso vërvshime të cilat në aspketin e fuqisë madhore ne nuk mund ti ndalim, por mbi të gjitha pak a shumë të iu dalim në ndihmë këtyre fshatrave. Unë besoj se vullneti i Kryetarit dhe ansambleistëve është që në kohën më optimale, këto 2 ura të riparohen, ndërtohen me buxhetin komunal me vullnetin tuaj.

**Nazmi Gashi** – Pyeti se a është prekë hekurudha prej ujit dhe rruga e asfaltuar.

**Hysni Mjeku** – Përgjegjet hekurudha jo, por rruga po dhe Kryetari ka qenë në vendin e ngjarjes. Mendoj se Drejtoria përkatëse duhet ta bëjë matjen e nivelit të ujit se deri ku mund të mbërrij lumi Drenica, por mbi të gjitha ne jemi këtu për ata qytetarë, që e kanë përfjetuar tmerrin e madh në kohën e vërvshimit.

**Nazmi Gashi** – Problemi është i historisë së Komunave, që kanë qenë vërvshimet dhe definitivisht Komuna e Obiliqit, ka kaluar më së miri. Problemi është se edhe atëherë kur e kemi ndërtuar atë urë janë mbledhur shumë banorë që ti jasin shenimet e sakta. Mendoj se infrastruktura duhet ti merrë shenimet nga njerëzit në atë lokalitet sepse ata e dijnë më së miri dhe ne pa u bërë bashkë nuk kemi zgjidhje të mirë.

**Arbnore Nasufi** – Unë kam një kërkësë prej Komitetit për komunitete, është kërkesa e anëtarëve që të dijnë arsyen pse në faqen zyrtare të Komunës, nuk publikohen mbledhjet që i mban Komiteti për komunitete. Kjo është kërkësë e kahmotshme e tyre, por duke parë se nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, ata na janë drejtuar neve si anëtarë të Kuvendit, me shqyrtau në mbledhjen e sotme.

**Shaip Paloja** – Unë i kam 2 kërkesa dhe njëra vjen nga qytetarët e fshatit Lajthishtë, rruga kryesore që lidhë pjesën e Qyqavicës me rrugë të fshatit.

Është e vërtetë se aty është shembë dheu dhe kalimi aty pothuajse është i pamundur dhe mundësishët është mirë që në fillim të pranverës aty, Komuna të intervenoj. Kërkesa tjetër është një aneks i rrugës: "Shtabi i UÇK-së" është një pronë në lagje, por rruga është publike që do të thotë se nuk ka pengesa ligjore për atë aneks që të rregullohet. Për këtë rrugë e kam bërë edhe kërkësën në Kuvendin komunal, por sigurisht se këtu nuk ka mbërrri.

**Kryetari** – I përgjegjet z. Dragan Dancetovic, sinqerisht mund të them se është fat i mirë, sidomos qendra i kemi zgjidhë si problem ujërat atmosferike dhe në këtë rast është dëshmue se degëzimet rreth hekurudhës dhe në anën tjetër në drejtim të Termocentralit "Kosova B" na kanë shpëtuar nga vërvshimet e brendshme që i kemi pasë. Janë 30 familje, të prekura me rastin e fundit të vërvshimeve, kryesisht janë fshati Bakshi, Raskovë, një pjesë e Breznicës dhe Kozaricës si dhe pjesa nga Grabofci, Shipitulla dhe Plementini. Për dallim prej urave tjera, kjo është shpëtue në aspektin e vërvshimeve në këtë pjesën tjetër duke falenderuar edhe atë që tha z.Dragan, pastrimi i lumenjve në kët rast Sitnica, Llapia dhe Drenica. Sa i përket çështjes së kamerave, ne e kemi diskutue edhe me komandantin e policisë dhe është një projekt i përbashkët me OSBE-në, që shpresoj se do të realizohet, janë 16, apo 17 kamera. Mbi të gjitha edhe jemi të interesuar që të jemi bashkëfinancues nga vija e bashkëfinancimit dhe jo vetëm në Baimoc, por në gjithë territorin e Komunës, të inicojmë çështjen e mbikqyrjes. Sa i përket kanalizimit, e di se janë në proces, kanë qenë në dhjetor, por janë edhe në janar dhe në këtë vit do të trajtohet në Baimoc. Nëse, nuk gaboj projektin e kanë në përmbyllje dhe kanë me bë një bashkëbisedim me qytetarë, që edhe kjo ka qenë meritë se ku janë pikat më të dobëta. Për urën rië Grabofc, ne e kemi thirrë kompaninë projektuese dhe menjëherë e ka bërë projektimin dhe derisa bëhet alokimi i mjeteve në buxhet nuk mund ta shpallim, por besoj shumë shpejtë kjo do të ndodhë. Sot bisedova me ministrin dhe me komandantin e FSK-së, kanë kërkesa të shumta të kësaj natyre dhe mbetet që bashkarisht ta bëjmë një vizitë te ura, apo me pa se cilat janë mundësítë, inxhinjerët tonë dhe inxhinjerët e FSK-së, derisa të bëhet realizimi i saj. Po ashtu, edhe drejtoresha Ilire, e ka bërë kërkësën që edhe ura e vjetër që është e trashëgimisë të ndërtohet dhe gjithashtu edhe ura tjetër. Unë pajtohem me z.Nazimi Gashi, se aty ku është ndërtue është marrë mendimi i qytetarëve dhe ajo pritet të zgjerohet për 10

metra, sepse gjatë kohës së vërvshimeve gjithë ai ujë i grumbulluar në fund godiste në një pikë të vetme, vinte komplet dhe hynte në fyt. Shpresoj se në projektet e para do të jetë ky sepse është i domosdoshëm. Ne e kemi zyrtarin z.Adem Haliti këtu, dhe të gjitha mbledhjet, procesverbalet e vendimet duhet të jenë në faqen zyrtare të Komunës. Sa i përket rrugës që e përmendi z.Shaip Paloja,”Shtabi i UÇK-së”, këtë vit është në planifikim dhe besoj se te nyja dhe te segmenti te “Shtabi i UÇK-së”, këtë vit do të trajtohet para fillimit të punimeve, ne do ta shohim se cilat do të jenë prioritetet në Komunën tonë dhe fillojmë.

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se hartimin e Planit të punës të Kuvendit komunal e kemi lënë për muajin shkurt. Po ashtu, edhe Komiteti për komunitete e ka një raport të punës. Gjatë muajit shkurt do të hartohej plani i punës të Kuvendit komunal dhe aprovohet edhe raporti vjetor i punës së Kuvendit komunal, duke përfshirë edhe Komitetin për komunitete.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:22’**

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri

